

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.S. nga Gjilani, për shkak të dy veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me neni 28 të KPRK-së dhe posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.91/2018 datë 12.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.11.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.91/2018 datë 12.07.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.91/2018 datë 12.07.2018, të akuzuarin V.S. e ka shpallur fajtorë për shkak të dy veprave penale, për çka e ka gjykuar për secilën veç e veç, Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me neni 28 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj ndërsa për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 i KPRK-së, e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, në kuptim të nenit 80 i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 10 (dhjetë) muaj të cilin duhet ta filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në dënim unik me burgim në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së të akuzuarit në fjalë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 14.04.2018 e gjer me 12.07.2018, kur edhe i është ndërprerë masa e paraburgimit me aktvendim të posaçëm. Të akuzuarit në fjalë në kuptim të nenit 69 të KPRK-së i shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i një thike me teher dhe dorezë të mbulueme me një material të paidentifikuar, ndërsa në kuptim të paragrafit 3 nenit 275 edhe substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 2.3 gram. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale lidhur me ekspertizën mjeko ligjore të paguaj shumën prej 40.88euro në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 45 euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm .

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi dënimin e shqiptuar, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit V.S. të i shqiptoj dënim me burg efektiv më të lartë se sa ai që i është shqiptuar me aktgjykimin e atakuar.

-Përgjigjë në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit V.S. av. S.R., i cili kërkon nga Gjykata Apelit që ta refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë dhe se aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj në kuptim të zbutjes së këtij dënimi.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk mori pjesë askush nga palët e ftuara me rregull.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.466/2018 të dt. 10.10.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore të aprovohet , kure përgjigja në ankesën e PTH e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit V.S. av. S.R. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore me Gjilan lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e Prokurorisë nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Prokuroria thekson se nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat me ndikim e sidomos ato rënduese të matjes së dënimit dhe se janë mbivlerësuar rrethanat lehtësuese pasi që të njëjtat nuk paraqesin rrethana veçanërisht lehtësuese për zbutjen e dënimit nën minimumin ligjor për këto dy vepra penale madje në rastin konkret as pranimit i fajësisë për veprën penale Vrasje në tentativë ngase pranimit i fajësisë është bërë tek në shqyrtimin kryesorë. Se i akuzuari është recidivist i disa veprave penale dhe është dashur të merret parasysh edhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë pranimit të fajësisë, dënimin e sinqertë, premtimin serioz se nuk do të përsërisë vepra penale në të ardhmen, moshën relativisht të re, se ka qenë për me se dy vite përdorues i substancës narkotike marihuanë e cila ka ndikuar negativisht në shëndetin e tij por edhe duke ia zvogëluar aftësinë për gjykim me rastin e ndërmarrjes së veprimit të kundërligjshëm ndaj të dëmtuarit, i dëmtuari nuk ka

paraqitur kërkesë pasurore juridike, kërkim faljen publike ndaj te dëmtuarit, bashkëpunimin me organet shtetërore për te dy veprat penale e ne mungesë te rrethanave rënduese vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësive penale të akuzuarve si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.490/18, më 06.11.2018

Procesmbajtës,
Eroll Gashi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____